INSTITUCION SHËNDETËSOR PUBLIK – KLINIKA UNIVERSITARE PËR KIRURGJI TORAKALE DHE VASKULARE

Llojë i revizionit: Период:

Revizioni i raporteve financiare dhe revizioni i pajtueshmërisë

2024

Mendimi i shprehur

Raportet financiare: 737 531

Pajtueshmëria: 737 531

Numri i llogarisë: 2

## Gjendjet kyçe të konstatuara:

- në pjesën e evidencës së rezervave me të cilat disponon Klinika, konstatuam se nuk është vendosur evidencë e përditësuar dhe me kohë e shpenzimit të barnave dhe materialeve në evidencën kontabël dhe materiale, ndërsa një pjesë e tyre janë furnizuar para lidhjes së kontratës, me qëllim që të sigurohej kryerja e pandërprerë e veprimtarisë. Gjithashtu, në kuadër të Klinikës nuk është formuar Farmacia Spitalore, përmes së cilës duhet të realizohet menaxhimi i rezervave;
- në një pjesë të procedurave të zbatuara të prokurimit publik është konstatuar zbatim joadekuat i Ligjit për Prokurimet Publike.
- një pjesë e kërkesave janë më të vjetra se tre vjet, për çka ekziston pasiguri lidhur me inkasimin e tyre në të ardhmen;
- është konstatuar dallim ndërmjet participimit të përllogaritur dhe atij të arkëtuar për shërbimet shëndetësore të kryera për personat e siguruar shëndetësorë.

## Theksim i çështjeve:

Ekziston disproporcion ndërmjet numrit të kontrolleve të rregullta dhe atyre urgjente të realizuara, si dhe ngarkesës së tepërt të Klinikës. Përkatësisht, 66% e numrit të përgjithshëm të kontrolleve të realizuara janë kryer në bazë të udhëzimeve urgjente ose udhëzimeve pa termin. Kjo strukturë e udhëzimeve tregon një devijim të konsiderueshëm nga mënyra e planifikuar e përdorimit të sistemit "Termini Im" dhe një ngarkesë të shtuar të Klinikës, gjë që mund të ndikojë në efikasitetin e planifikimit dhe organizimit të procesit të punës, në shfrytëzimin optimal të kapaciteteve në dispozicion, si dhe në qasjen e pacientëve në shërbimet shëndetësore.

Vërejtjet e dorëzuara: Po — Jo √ —

Rekomandimet e dhëna: 8

Përgjigjet e vërejtjeve: Po — Jo √ —

Link deri te raporti i revizionit:

Mendimi pozitiv | Mendimi me rezervë | Mendim të pavolitshëm | I përmbajtur në dhënjen e mendimit